



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Zhvillim kurrikule

Ngarkesa: 4kredite; 30 orë leksione 15 seminare;

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në "Mësuesi"

Kodi i etikës: Kodi i etikës UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studentët mësojnë të përshtatin proceset e mësimdhënies dhe të nxënit sipas nevojave specifike të nxënësve. Aftësohen të analizojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi bashkëpunues në klasë midis mësuesve dhe nxënësve. Aftësohen në aplikimin e strategjive të mësimdhënies që ndihmojnë në përmirësimin e të nxënit.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Studentët arrijnë të përshkruajnë elementet kryesore për zhvillimin e një kurrikule për mësimdhënien dhe të nxënit.
- 2. Arrijnë në përfundime konkrete për rëndësinë e strategjive të mësimdhënies që ndikojnë në përmirësimin e rezultateve të nxënësve.
3. Zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe zbatuar reforma arsimore, bazuar në nevojat specifike të shkollave dhe nxënësve.

Rezultate të pritshme:

Lënda "Zhvillim Kurrikule" trajton procesin e hartimit, implementimit dhe vlerësimit të kurrikulave në sistemin arsimor. Ajo përqendrohet në konceptet bazë të teorive kurrikulare, qëllimet dhe objektivat arsimore, dhe në mënyrat se si mund të zhvillohen dhe përshtaten kurrikulat në kontekstin e nevojave specifike të shkollave dhe nxënësve.